



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**RREGULLORE  
PËR PRIMET E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT**

*Miratuar me Vendim Bordi nr.75, datë 28.08.2009*

*Shfuqizuar me Vendim Bordi nr. 110, datë 28.07.2011*

**Neni 1  
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit të primeve dhe të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlllogaritjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, dhe përcaktimi I procedurave dhe afateve për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 10, të Ligjit nr.10 076, datë 12.02.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 3 të nenit 14, të Ligjit nr.9572, date 03.07.2006 “ Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

**Neni 3  
Përkufizime**

Termat janë përdorur në këtë rregullore me kuptimet e mëposhtme:

- 1.“**Autoriteti**” –nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
2. “**Shoqëria**” –nënkupton shoqërinë e sigurimit të licensuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e sigurimeve;
3. “**Primi i sigurimit**”, ose “**Primi**” nënkupton shumën që paguhet nga i siguruari,ose nga një person qe vepron në emër të tij tek siguruasi, me qëllim sigurimin ndaj një rreziku të përcaktuar në kontratën e sigurimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kontratë;

4. **“Primi bruto”** - i barazvlefshëm me primin e sigurimit;
5. **“Primi i rrezikut”** – nënkupton pjesën e primit të sigurimit të vlerësuar (i) për të mbuluar dëmet sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit dhe (ii) për të financuar kontributin e shoqërisë së sigurimit në fondin e kompensimit, sipas parashikimeve të nenit 45 të të Ligjit nr.10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
6. **“Ngarkesa mbi primin e rrezikut”** - nënkupton fitimin e vlerësuar nga shoqëria dhe të gjitha kostot e lidhura me policën e sigurimit, me përjashtim të dëmeve dhe kontributit për fondin e kompensimit;
7. **“Aktuari i autorizuar”** – nënkupton personin e autorizuar nga AMF sipas parashikimeve të Ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, neni 3/16, neni 66, neni 67;
8. **“Komiteti i Aktuarëve”** – nënkupton grupin e ekspertëve të përbërë nga aktuarët e autorizuar të shoqërive dhe aktuari përfaqësues i Autoritetit.

## **KREU I**

### **Primi për sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik dhe për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.**

#### **Neni 4 Komiteti i Aktuarëve**

1. Pranë Autoritetit ngrihet komiteti i aktuarëve si grup konsultativ, i cili ka për detyrë të hartojë tabelat e primit të rrezikut sipas kategorive të përcaktuara për produktet motorike për sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik dhe për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
2. Kryetari Autoritetit, përcakton përbërjen e komitetit të aktuarëve, detyrat konkrete dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.
3. Komiteti i aktuarëve i merr vendimet me konsensus. Në rast të mungesës së konsensusit në komitetin e aktuarëve, komiteti i merr vendimet me shumicë votash. Në rast të barazimit të votave pro dhe kundër, vota e Kryetarit të komitetit do të numërohet dy herë.
4. Autoriteti i garanton komitetit të aktuarëve ambiente të përshtatshme për kryerjen e detyrës dhe të gjithë bazën e të dhënave të nevojshme për të kryer vlerësimet aktuariale.

## Neni 5

### Bazat e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të rrezikut

1. Në hartimin e tabelave të primeve të rrezikut, komiteti i aktuarëve duhet të marrë parasysh një bazë të gjerë të dhënash statistikore të tregut për një periudhë që përfshin të paktën 5 vitet e fundit. Baza e të dhënave duhet të përfshijë edhe të dhënat për dëmet e regjistruara për llogari të fondit të kompensimit në periudhën që merret në shqyrtim.
2. Baza e të dhënave statistikore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë specifikime dhe detaje të policave të sigurimit dhe dëmeve sipas:
  - a) kategorisë së automjetit për policat dhe dëmet;
  - b) kohëzgjatjes së mbulimit në sigurim të policave;
  - c) llojit të dëmit (shëndetësor, material, moral, biologjik dhe ekzistencial);
  - d) shtrirjes territoriale të policave të lëshuara / dëmeve të ndodhura;
  - e) përfshirjes së procesit gjyqësor në trajtimin dhe vlerësimin e dëmit;
  - f) elementë të tjerë që mund të përdoren në procesin e vlerësimit aktuarial të primit të rrezikut.
3. Komiteti i aktuarëve harton tabelat dhe kryen vlerësimin e primit të rrezikut sipas metodave të njohura aktuariale që përfshijnë edhe analizën e ndikimit të faktorëve ekonomikë dhe financiarë të përgjithshëm, apo të lidhur në veçanti me produktin.

## Neni 6

### Raporti aktuarial

Tabelat e primeve të rrezikut të përcaktuara nga komiteti i aktuarëve shoqërohen me një raport aktuarial që paraqet në mënyrë të detajuar:

- a) vlerësime mbi profilin e rrezikut të çdo produkti dhe tendencat e shfaqura;
- b) vlerësime për dëme të mëdha dhe tendencat;
- c) metodën statistikore të përdorur në llogaritjen e demit mesatar të rregulluar;
- d) frekuencën e dëmeve të rregulluar;
- e) normën e pritshme të inflacionit të përgjithshëm dhe atij të produktit;
- f) koeficientin e pritshëm për fondin e kompensimit;
- g) metodat statistikore dhe aktuariale të përdorura në vlerësimin e çdo elementi tjetër të primit të rrezikut, përfshirë këtu gjykimet mbi efektin moral, biologjik dhe ekzistencial.

## Neni 7

### Miratimi i tabelave të primit të rrezikut nga Autoriteti

1. Komiteti i aktuarëve dorëzon tek Kryetari i Autoritetit, tabelat e primeve të rrezikut dhe raportin aktuarial.

2. Bordi i Autoritetit me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit merr vendim për miratimin e tabelave të primit të rrezikut që do të zbatohen nga shoqëritë për një periudhë të paktën 1 (një) vjecare.
3. Vendimi i Bordit të Autoritetit, së bashku me tabelat e miratuara të primit të rrezikut, publikohen në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit dhe u dërgohen me shkresë zyrtare shoqërive, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit.

### **Neni 8**

#### **Llogaritja e primit të sigurimit nga shoqëritë**

1. Tabelat e primit të rrezikut të miratuara nga Autoriteti shërbejnë si bazë për hartimin e tabelave të primeve të sigurimit nga shoqëritë.
2. Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut me ngarkesën mbi primin e rrezikut.
3. Ngarkesa mbi primin e rrezikut përcaktohet nga shoqëria e sigurimit, bazuar në tabelat e miratuara të primit të rrezikut, në planin e saj të biznesit për produktin dhe në vlerësimet e aktuarit të saj të autorizuar.
4. Niveli i ngarkesës mbi primin e rrezikut nuk duhet të kalojë masën 25% të primit të sigurimit.

### **Neni 9**

#### **Miratimi i tabelës së primeve të sigurimit të shoqërise së sigurimit**

1. Shoqëria depoziton për miratim në Autoritet tabelat e primeve të sigurimit të nënshkuara nga aktuari i autorizuar i shoqërisë, brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të Bordit të Autoritetit, sipas pikës 3 të nenit 7.
2. Tabelat e primeve të sigurimit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe të shoqërohen me raportin e aktuarit të autorizuar në lidhje me ngarkesën mbi primin e rrezikut.

### **Neni 10**

#### **Procedurat e miratimit të primit të sigurimit**

1. Autoriteti, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës, njofton shoqërinë për miratimin ose jo të tabelave të primit të sigurimit të depozituara prej saj. Mos miratimi i tabelave shoqërohet me raportin përkatës nga ana e Autoritetit.
2. Shoqëria zbaton tabelat e primeve të sigurimit vetëm pas miratimit nga Autoriteti dhe njofton Autoritetin për datën e fillimit të zbatimit të tyre.
3. Tabelat e primeve të sigurimeve të miratuara nga Autoriteti janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëria për një periudhë të paktën 1-vjeçare nga data e miratimit, me përjashtim të rasteve kur Autoriteti merr vendim për rishikimin e tyre.

## **Neni 11**

### **Publikimi i primeve**

1. Shoqëria publikon tabelat me primet e miratuara të sigurimit në faqen e saj të internetit të paktën 10 ditë kalendarike para zbatimit të tyre dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.
2. Tabelat me primet e miratuara të sigurimit duhet të qëndrojnë të afishuara në çdo pikë të shitjes së shoqërisë, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të tyre.

## **Neni 12**

### **Provigjoni teknik i primit të pafiturar dhe i dëmeve**

1. Provigjoni teknik i primit të pafiturar llogaritet nga aktuari i autorizuar i shoqërisë për çdo policë sigurimi dhe nuk është më i ulët se pjesa proporcionale e primit të rrezikut, për periudhën e paskaduar të policës së sigurimit.
2. Provigjoni teknik i dëmeve llogaritet sipas përcaktimeve të Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të jo-jetës”.

## **KREU II**

### **Primet për sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik dhe sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të avionit/mjetit lundrues**

## **Neni 13**

### **Përcaktimi i nivelit të primit të sigurimit**

1. Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut me ngarkesën mbi primin e rrezikut.
2. Ngarkesa mbi primin e rrezikut përcaktohet nga shoqëria e sigurimit, bazuar në tabelat e miratuara të primit të rrezikut, në planin e saj të biznesit për produktin dhe në vlerësimet e aktuarit të saj të autorizuar.
3. Ekspertët e shoqërisë, në bashkëpunim me aktuarin e autorizuar të saj përcaktojnë nivelin e primit të sigurimit duke patur parasysh:
  - a) ekspertizën për produktin dhe vlerësimet aktuariale;
  - b) eksperiencën e produktit në tregun Shqiptar të sigurimeve;
  - c) tendencat e tregut ndërkombëtar të risigurimeve dhe bashkëpunimit me risiguruesit përkatës.

## **Neni 14**

### **Procedurat e miratimit të primit të sigurimit**

1. Shoqëria, brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i kësaj rregulloreje, depoziton në Autoritet tabelat e primeve, ose tarifave të primit, të shoqëruara me bazën teknike dhe metodikat e përdorura për përlogaritjen e tyre.
2. Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit përgatit informacionin dhe paraqet opinionin për Bordin e Autoritetit lidhur me kërkesën e shoqërisë së sigurimit për miratimin e tabelës së primeve pas:
  - a) analizimit të të gjithë bazës teknike të të dhënave dhe tabelës së primeve;
  - b) përdorimit të metodikave statistikore dhe aktuariale;
  - c) vlerësimit të Plan Biznesin të depozituar;
  - d) organizimit të takimeve me aktuarin e autorizuar të shoqërisë;
  - e) shqyrtimit të dokumentacionin shtesë të kërkuar në rastin kur e shikon të arsyeshme.
3. Autoriteti, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës, njofton shoqërinë e sigurimit për miratimin ose jo të primeve të sigurimit të detyrueshëm nga Bordi i Autoritetit.
4. Nëse Autoriteti konstaton se tabelat e primeve nuk janë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, parimet aktuariale dhe praktikat e tregut ia kthen shoqërisë së sigurimit për rishikim me vërejtjet përkatëse.
5. Shoqëria e sigurimit zbaton tabelat e primeve të sigurimit vetëm pas miratimit nga Autoriteti.

### **Neni 15** **Dispozita tranzitore**

1. Shoqëria zbaton tabelat e primit të sigurimit, ose tarifave të primit të sigurimit të mëparshme, deri në miratimin nga Autoriteti të tabelave të reja të primeve të sigurimit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

### **Neni 16** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

**Elisabeta GJONI**  
**KRYETAR**